



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

**SHPALLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:
PËRGJEGJËS SEKTORI
DREJTORIA E NVM DHE PROJEKTEVE**

1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:

Emërtesa e pozicionit: Përgjegjës në sektorin e Projekteve dhe Inovacionit

Klasa e pagës: III-1

Drejtoria: Drejtoria e NVM dhe Projekte

Raporton te: Drejtori i Drejtorisë së NVM dhe Projekteve

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT: Përgjegjësi i Sektorit të Inovacionit dhe projekteve përgjigjet te Drejtori i Drejtorisë së NVM dhe Projekteve për zbatimin e detyrave dhe përmbushjes së objektivave, në lidhje me mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare, sipas funksioneve përkatëse ligjore dhe nënligjore.

3. DETYRAT KRYESORE:

- Zhvillon dhe zbaton një strategji gjithëpërfshirëse të projekteve dhe inovacionit në përputhje me misionin dhe qëllimet e agjencisë;
- Identifikon, menaxhon dhe shkruan projekt propozime sipas nevojave të bizneseve shqiptare dhe në përputhje me objektivat e Agjencisë;
- Zhvillon dhe menaxhon buxhetet e projektit, afatet kohore dhe treguesit kryesorë të performancës (KPI) për të siguruar ofrimin e suksesshëm të projektit;
- Monitoron progresin e projekteve, identifikon çështjet e mundshme dhe zbaton veprime sipas nevojës;
- Identifikon dhe priorizon fushat për inovacion dhe promovim të eksportit, duke marrë parasysh tendencat e tregut dhe dinamikat e industrisë;
- Identifikon teknologjitë dhe tendencat në zhvillim, me qëllim promovimin e eksportit;
- Ofron raporte të rregullta për drejtuesin e Agjencisë dhe palët e interesuara mbi performancën dhe rezultatet e projekteve;
- Siguron që të gjitha projektet dhe aktivitetet e inovacionit të jenë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe standardet përkatëse;
- Propozon rekomandime për përmirësimin e politikave në fushën e inovacionit në biznes;
- Nxist një mjedis pune bashkëpunues dhe inovativ.

4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDITATI

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

5. KËRKESAT E POSAÇME:

Arsimi minimal: Master shkencor në shkenca juridike/ekonomike. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të ketë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë pune.

Tjetër: Njohuri shumë të mira të specialiteteve brenda një fushe të caktuar profesionale dhe të politikave e programeve lidhur me fushën e specialitetit; aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;
- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim ,dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(02.10.2023 afati i fundit i aplikimit).**

7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në vijim, AIDA do të realizojë:

- a- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore.
- b- Nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.
- c- Nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës, faza e dytë të konkurrimit e cila është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditë nga përfundimi i vlerësimit.